



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ibadete Guri	16.09.2024	28.09.2024	2024/0843

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.09.2024, OE “Pro Acc Group SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0843, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për kontratë , lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rivleresimi i Aseteve ne Ndermarrjen Publike NH “Iber Lepenc” Sh.a.” me nr. të prokurimit: "IL-24-8711-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ndermarrja Hidroekonomike Iber Lepenc SH.A..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Ligji për Prokurim Publik nr. 04/L-042, i amendamentuar me ligje tjera

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 – Dosja e tenderit

Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 66 – Pershtatshmeria Profesionale

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 108/A – Zgjidhja Preliminare e Mosmarveshjeve

Rregullorja me nr. 001/2022, për Prokurim Publik.

Neni 97 i Rregullores për prokurim publik nr. 001/2023

Pretendimet ankimore:

Eksperti gjate vlerësimit te pretendimeve ankimore konsideron se OE ankues nuk është pajtuar me Vendimin e AK-s per trajtimin e kerkeses per rishqyrtim te kerkesave te vendosura ne DT si te **pa bazuar** , duke pretenduar se kerkesat e vendosura ne dosjen e tendrit dh ne Njoftimin per Kontrate nga AK-ja jan diskriminuese / favorizuese ,e te cilat jane:

Pretendimi 1

Pergjegjesia, serioziteti dhe profesionalizmi i zyrtareve përgjegjës te prokurimit është treguar ne vendimin e datës 05.09.2024, ku është nxjerrur ndaj kerkeses sonë për ri shqyrtim ku AK – NH "Iber Lepenc" sha, gjegjesisht zyrtaret përgjegjës te prokurimit nxjerrin vendim për refuzim te kerkeses për ri shqyrtim për procedur tjetër te prokurimit dhe Operator tjetër, përkatësisht ngaterrohen procedurat e prokurimit.

Veprime këto formale dhe pa kurrefar serioziteti ne pune nuk mund te konsiderohen si gabime teknike, veprimi i tille shperfaq pa pergjegjshmerin profesionale dhe jo seriozitetin ne ushtrimin e detyres zyrtare.

Vendimi i është drejtuar kompanis sonë.

Ne arsyetim pershkruehet kompani tjetër dhe aktivitet tjetër, përkatësisht procedura për "Furnizim me paisje GPS...". Ne si kompani kemi parashtruar kerkese për ri shqyrtim ndaj procedurës se prokurimit "Rivlereimi i aseteve ne NPH "Iber Lepenci" sha me nr IL-24-8711-2-2-1.

Dispozitat e nenit 108/A i LPP-se qarte percakton qe

Par 2 percakton:

Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkëlja e pretenduar.

Par 8, pika 8.4 percaktojne

Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:

8.4 Autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.

Ndërsa par 8 i te njejtí nen percakton:

Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.

Pretendimi 2

Kompania jone edhe ne proceduren paraprake atë te publikuar ne vitin 2023, kishte parashtruar kerkese për ri shqyrtim e kishte raportuar kufizimin e konkurrences, i kishte raportuar shkeljet ligjore nga AK – Iber Lepenci sha, rrjedhimisht edhe tani përmes kesaje procedure te prokurimit tentohet te lidhet kontrate me operator ekonomik te caktuar, por përmes procedurës se hapur, ndërsa kerkesat e aplikuar ne dosje te te nderit dhe njoftim për kontrate flasin për kufizim te konkureses, tentativ te eliminimit te konkurrences se lire, përkatësisht kurdisje te tenderit.

Pretendimi 3

Tek kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ne anen tjetër eshte kerkuar: "OE duhet te ofroj dëshmi se ka perfunduar kontrata te sherbimeve te natyres se ngjashme....", rrjedhimisht ne te njeften kerkese, është potencuar se natyre e ngjashme ka te beje me RIVLERESIM TE ASETEVE"!

Ne njeren ane kerkohen referenca te natyres se ngjashme ne anen tjetër sipas deshmise kerkohet referenc te natyres se njëjtë apo identike me aktivitetin e prokurimit gjegjesisht Rivlereim Asetesh !.

Kerkesa me deshmine kane shperputhje dhe si e tille perveq lajthitjes eventuale te kompanive, kjo kerkese kualifikuese është tipike kufizuese, gjegjesisht diskriminuese dhe qon ne lidhje te kontratës me kompani te caktuar.

Paradoksi tjetër qëndron tek kerkesat për stafin kyq ku është kerkuar:

- **Udheheqesin e Projektit Auditor te certifikuar me 5 vite pervoje pune**
- **Kontabilist te certifikuar (2) me pervoj pune jo me pak se 3 vite**
- **Inxhinier te ndertimtarise -konstruktiv**
- **Inxhinier te ndertimtarise - hidro**
- **Inxhinier te ndertimtarise - makineri**
- **Ingjinier te IT**

Te gjithë stafi dhe pervoja e aplikuar me nga 5 vite pas diplomimit i referohen kompanis se caktuar. Ndërsa sipas deshmise dokumentare eshte kekruar CV dhe referenca qe deshmon se jane realizuar pune te ngjashme !

Ne këtë situare për referencat e puneve te ngjashme nuk është specifikuar cilat janë punet e ngjashme ashtu siç është përcaktuar tek kekesa 1 qe ka te beje me projektet

6/4

dhe punet e realizuara.

Këto kerkesa janë tipike favorizuese, por qellimi i caktuar, favorizimi dhe kurdisja e tille do duhej te sanksionohej ashtu siç percaktohet me dispozita ligjore gjegjesisht nenin 97, te Rregullores për Prokurim Publik dhe si e tille konsiderohet si shkelje e

Pretendimi 4

Tek ankesi 1 - specifikacionet teknike te detyrueshme, AK ne dosje te tenderit si qellim te kontratës – objektivat e projektit përshkruhet si mëposhtë:

- a. Te përcaktohet vlera e drejte e tregut e aktiviteve te prekshme, te tilla si pasurite e paluajtshme, makineritë, pajisjet dhe inventari.*
- b. Te vlerësohet vlera e aktiviteve te paprekshme siç është pronësia intelektuale.*
- c. Te vlerësohet saktësia e vlerës se aseteve ne pasqyrat financiare te ndërmarrjes.*
- d. Te ofrohet lista e aktiviteve te cilat duhet te fshihen ose zhvlerësohen me tepër ose me pak sesa janë zhvlerësuar deri tani.*
- e. Te sigurohet përputhshmëria me standardet përkatëse te kontabilitetit SNRF, GAP dhe kërkesat rregullore.*

Ndërsa ne piken tjetër – **Fushëveprimtaria**, përshkruhet:

- a. Rishikimi i pasqyrave financiare*
- b. Lista dhe dokumentacionet e aseteve*
- c. Hulumtimi dhe analiza e tregut*
- d. Metoda e vlerësimit*
- e. Raportimi.*

Pra objekti i kontratës ka te beje kryesisht me vlerësim te aseteve dhe për vlerësim te aseteve detyrimisht do duhej te kerkohej kompani e cila mireet me vlereim te pronave apo aseteve, gjegjesisht ekspert te certifikuar nga KGJK, për vlereim te pronave dhe jo te kerkojet Kompani e Auditimit, Auditor dhe kontabilist, madje, për kufizim te sigurt te konkurrences AK, nuk lejoni qe parakontrate apo marreveshje me stafin përkatësisht kontraktimin për angazhim ne projekt !

Neni 66 – Përshtatshmëria profesionale (LPP) ku AK, ka kërkuar licence ndaj kompanisë për auditim, madje për secilin nga anëtarët e grupit, bie ndesh me dispozitat e te njëjtit nen, pasi qe mund tek pershtatshmeria profesionale mund te kerkohet Certifikata apo ni regjistër ndaj biznesit siç është certifikata e biznesit dhe ajo e TVSH-se, por jo edhe certifikimet tjera kualifikuese.

Ndërsa ne paragrafin 2 te te njejtit nen kjarte përcaktohet se mund te kerkohet

autorizim apo licence për ofrim të shërbimeve profesionale por në rastet kur shërbimet ofrohen vetëm nga një OE.

Sipas nenit 69 të LPP-se, ju si AK mund të kërkontë kualifikime profesionale – licence për auditim apo edhe auditor të certifikuar, licence për vlerësim të pronave dhe asetëve apo edhe ekspert të licencuar për vlerësim të pronave. Të kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ju si AK keni kërkuar kualifikime profesionale të cilat nuk kanë të bëjnë fare me natyrën dhe objektin e kontratës, siç është menaxheri i projektit, ku ju si AK nuk keni kërkuar kurrfarë kualifikimi profesional, në anën tjetër keni kërkuar që i njëjti të jetë auditor ligjor me së paku 5 viteve përvojë pune; keni kërkuar kontabilist; inxhinier – drejtimi konstruktiv; drejtimi hidro dhe TI.

Neni 27, paragrafi 1 i LPP-se, përcakton: “Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet 8 materiale të saj.”.

Edhe Neni 52, paragrafi 3 i LPP-se shumë qartë përcakton se: “... **autoriteti kontraktues mund të përdor vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lenden e kontratës.**”

Për më tepër, nëse kompani nuk e kemi të kësaj raste rolet e inxhinierëve të ndërtimitaris, kualifikimet – Konstruksion, hidro e të tjerë dhe anashkalimin e vlerësuesve të certifikuar të pronave apo asetëve.

Prandaj bazuar në provat, faktet dhe dëshmitë e prezantuara si më sipër kërkojmë nga OSHP, që të autorizohet ekspert shqyrtues profesiona, i pa varuar njohës i dispozitave ligjore për Prokurim Publik dhe bazuar në nenin 113 të LPP-se të trajtoj në tërësi pretendimet tona ankimore në atë mënyrë që paneli shqyrtues të nxjerrë këto:

KRITERET PËR VLERËSIM

<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p>	<p>9.1 & 9.2</p>	<p>Tehničke i profesionalne mogućnosti Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për shërbime të natyrës së ngjajshme në vlerë prej 150.000 EURO në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Pune të ngjajshme pranohen dëshmi të kontratave të rivleresimit të asetëve, në mënyrë që të OE të jenë kompani profesionale në fushën përkatëse të Rivleresimit të Asetëve sipas Standardeve Nderkombetare të Raportimit Financiar.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> Operatorët ekonomik duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë një listë që specifikon shërbimet e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, dhe të njëjtën ta nënshkruajnë dhe vulosin. Si dhe kopje të dëshmive përkatëse; (i) kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur shërbimi është bërë për një subjekt privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga pranuesi i shërmimit dhe evidentimi i shërbimit të tillë</p>
--	----------------------	---	--

		<p>Stafi profesional Kompania duhet të ofroj dëshmi se ka të angazhuar ose do të angazhoj staf të kualifikuar dhe me përvojë për këto profile 1.1. Një (1) udhëheqës - menaxher i caktuar i projektit, përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve dhe sigurimin e përfundimit në kohë. Udhëheqësi i projektit duhet të jetë auditor ligjor dhe të ketë së paku 5 vite përvojë punë në auditim, 1.2. Dy (2) kontabilistë të certifikuar të cilët kanë së paku 3 vite përvojë pune në kontabilitet, 1.3. Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me së paku 5 vite përvojë pune në fushën e ndërtimtarisë, 1.4. Një (1) ndërtimtarisë – drejtimi i hidros, me së paku 5 vite përvojë pune në fushën e hidros, 1.5. Një (1) i makinerisë me së paku 5 vite përvojë pune në fushën e makinerisë, dhe 1.6. Një (1) i teknologjisë informative me së paku 5 vite përvojë pune në fushën e teknologjisë informative.</p>	<p>Dëshmitë e kërkuara nënshkruar dhe vulosur dëshmon për stafin e angajuar tregon emrin, mbiemrin, cilin tregon emrin, mbiemrin, pozicionin per secilin staf. pozitën 1.1 (udhëheqës) kërkohej Vendim për udhëheqësit të projektit, diplomës, CV e nënshkruar udheheqësi i projektit dhe dëshmon se ka kryer me sukses ngjajshme. - Për pozitën 1.6 kërkohej kopja e diplomës nënshkruar nga secili staf dhe referenca për secilin staf që ka kryer me sukse punë të ngjajshme.</p>
<p>Aneksi 1-Specifikat teknike te Detyrueshme -Termet e Referencës për Vlerësimin e Aseteve në ndërmarrjen publike</p>			

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues vlersohet se është pale me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-s

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Pro Acc Group SH.P.K.

Përgjigje në pretendimet ankimore

Eksperti shqyrtues ka analizuar në mënyrë të hollësishme ankesën, duke i trajtuar të gjitha pretendimet ankimore dhe atë:

Pretendimi ankimor nr. 1 – Në këtë pretendim, OE ankues pretendon se zyrtari përgjegjës i prokurimit ka drejtuar vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim tek parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim, por që në përshkrim i është referuar procedurës “Furnizim me pajisje GPS...” dhe OE-së, i cili nuk ishte parashtrues i kërkesës për rishqyrtim, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat e nenit 108/A të LPP-së dhe po ashtu është shkelur pika 8.4 e këtij neni.

Po ashtu, OE ankues pretendon se AK-ja ka shkelur nenin 108/A dhe nenin 109, pasi që nuk ka bërë zgjatje të afatit kohor për dorëzimin e tenderëve, pasi ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimin lartëshënuar: Eksperti shqyrtues sqaron se, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, analizimit të fakteve dhe argumenteve, bazuar në Ligjin për Prokurim Publik, neni 108/A, pretendimi ankimor i OE-së ankues qëndron. Ndërsa sa i përket pretendimit se AK-ja ka shkelur nenin 108/A dhe 109 të LPP-së, nuk qëndron, pasi këto nene nuk flasin për veprimet që duhet të ndërmerret AK-ja në rastet e refuzimit të një kërkesë për rishqyrtim, por për këtë rast flet Rregullorja për Prokurimin Publik, në nenparagrafin 63.1.1.b) të nenit 63, në të cilin nen thuhet: "Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit, duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit." Andaj, në këtë rast, AK-ja ka vepruar në harmoni të plotë me nenin e lartpërmendur në Rregulloren për Prokurim Publik.

Përmbledhje e konstatimit të ekspertit shqyrtues në pretendimin nr. 1 është se vlerësohet të jetë pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor nr. 2 – Në këtë pretendim ankimor, OE ankues pretendon se AK, me vendosjen e kërkesave kualifikuese në dosjen e tenderit, ka bërë kufizimin e konkurrencës, gjë që njëjtë kishte vepruar edhe për të njëjtin aktivitet të publikuar më parë.

Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimin lartëshënuar: Eksperti shqyrtues sqaron se, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, analizimit të fakteve dhe argumenteve, ku AK-ja, me rastin e vendosjes së kërkesave kualifikuese në DT dhe në NjK, të cilat bien në kundërshtim me vetë natyrën e aktivitetit, konsiderohen se janë kërkesa që e kufizojnë tregun. Nisur nga vet titulli i aktivitetit të prokurimit, "Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH "Ibër Lepenc"" dhe krahasimi me kërkesat kualifikuese të vendosura në DT për përzgjedhjen e OE-ve të përgjegjshëm.

Përmbledhje e konstatimit të ekspertit shqyrtues në pretendimin nr. 2 vlerësohet të jetë i bazua

Pretendimi ankimor nr. 3 – Në këtë pretendim ankimor, OE ankues pretendon se AK-ja ka bërë shkelje të nenit 7, pikës 2 të këtij neni në LPP, dhe po ashtu nenit 71 në LPP, ku me rastin e vendosjes në FDT, tek nenet 7.1 dhe 7.2 – Përshtatshmëria profesionale, kërkesën nr. 2, si:

Kërkesa: Operatorët Ekonomik duhet të jenë kompani e licencuar e auditimit. Edhe në rast të Grupit të OE, të gjithë anëtarët e grupit duhet të dëshmojnë se janë të licencuar si kompani të auditimit.

Dëshmia: Kopje e licencës valide për kompani të auditimit (edhe për anëtarët e Grupit!)

Po ashtu, në këtë pretendim OE ankues pretendon se kërkesa për kompani të licencuar për auditim bie në kundërshtim me natyrën e aktivitetit dhe këtë e konsideron kufizim të konkurrencës dhe në kundërshtim me objektin e kontratës.

Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimin lartëshënuar: Eksperti shqyrtues sqaron se, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, analizimit të fakteve dhe argumenteve, pretendimi ankimor qëndron për faktin se, bazuar në nenin 71, pika 4 e këtij neni në LPP, në të cilin nen i referohet Grupit të Operatorëve Ekonomik, ku në pikën 4 të këtij neni shumë qartë e specifikon se: "Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenëve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të grupit." Andaj, kërkesa e AK-së që edhe anëtarët e Grupit të jenë të licencuar si kompani e auditimit bie në kundërshtim të plotë me nenin 71 të LPP-së.

Po ashtu, me të drejtë OE ankues në pretendimin potencon se kërkesa e AK-së që OE-të të jenë Auditorë të Licencuar bie në kundërshtim me objektin e kontratës, pasi që vetë AK-ja në FTD, në nenin 2.1, tek Qëllimi i Kontratës, ka shënuar se: "**Qëllimi i kontratës është performimi i shërbimeve në vijim: Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH Ibër Lepenc Sh.a., komplet asetet e Ibër Lepenc-it, sipas specifikacioneve teknike, në Dosjen e Tenderit.**" Në këtë rast, AK-ja ka qen dashur të mendojë se si kompania e licencuar për auditim do të bëjë rivlerësimin e asetëve, pasi që auditorët nuk bëjnë vlerësimin e asetëve, por ata rishikojnë dhe verifikojnë që vlerat e asetëve të raportuara në

pasqyrat financiare janë të sakta dhe përputhen me standardet e kontabilitetit dhe kërkesat rregullatore. Ata gjithashtu sigurohen që këto vlera janë regjistruar saktë në librat financiarë dhe janë zhvlerësuar në përputhje me rregullat, por që vlerësimin e asetëve duhet ta bëjnë vlerësuesit e asetëve, jo auditorët. Vlerësuesit e asetëve janë ekspertë të specializuar që përcaktojnë vlerën e drejtë të tregut të asetëve, si për ato të prekshme (pasuri të paluajtshme, makineri, pajisje, inventar) ashtu edhe për ato të paprekshme (pronësi intelektuale). AK-ja gjatë hartimit të Termave të Referencës.

AK-ja duhet të përcaktohet se a kërkohet, përmes këtij aktiviteti të prokurimit, të bëhet rivlerësimi i asetëve, regjistrimi etj., apo duhen të sigurohen që vlerësimet e asetëve dhe procedurat e kontabilitetit janë në përputhje me standardet dhe ligjet financiare.

AK-ja gjatë përpilimit të Specifikimeve teknike/Termave të Referencës ta ketë për bazë nenin 28, konkretisht pikën 2 të këtij neni të LPP-së.

Përmbledhje e konstatimit të ekspertit shqyrtues në pretendimin nr. 3 vlerësohet të jetë i bazuar.

Pretendimi ankimor nr.3 (edhe pse sipas radhes ky eshte pretendimi i katert por meqense se OE ankues keshtu ju ka referu edhe eksperti shqyrtues ne shqyrtimin e tij po ju refereohet njejt si OE ankues) -Në këtë pretendim ankimor ,OE ankues pretendon se AK-ja me rastin e vendosjes së kërkeses nr.1 te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ,kërkesën se : Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për **shërbime të natyrës së ngjajshme** në vlerë prej 150.000 EURO në 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë. **Pune te ngjajshme pranohen dëshmi te kontratave te rivleresimit te asetëve**, në mënyrë që OE- të jenë kompani profesionale në fushën perkatesë të Rivleresimit të Aseteve sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar . AK-ja në njerën anën thotë të natyrës së ngjajshme e në anën tjetër në të njejtën kërkes thot se pranohet dëshmi të kontratave të rivleresimit të asetëve dhe kjo për OE ankues është shperputhje dhe i vlerson si kërkesa kufizuese/diskriminuese . Po ashtu OE ankues pretendon se kërkesa për stafin profesional janë kërkesa favorizuese /diskriminuese si : Kërkesat -Kompania duhet të ofroj dëshmi se ka të angazhuar ose do të angazhoj staf të kualifikuar dhe me përvojë për këto profile :

- 1.1. Një (1) udhëheqës - menaxher i caktuar i projektit, përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve dhe sigurimin e përfundimit në kohë. Udhëheqësi i projektit duhet të jetë auditor ligjor dhe të ketë së paku 5 vite përvojë punë në auditim,
- 1.2. Dy (2) kontabilistë të certifikuar të cilët kanë së paku 3 vite përvojë pune në kontabilitet,
- 1.3. Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv me së paku 5 vite përvojë pune në fushën e ndërtimtarisë,
- 1.4. Një (1) ndërtimtarisë – drejtimi i hidros, me së paku 5 vite përvojë pune në fushën e hidros,
- 1.5. Një (1) i makinerisë me së paku 5 vite përvojë pune në fushën e makinerisë, dhe
- 1.6. Një (1) i teknologjisë informative me së paku 5 vite përvojë pune në fushën e teknologjisë informative.

Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimin ankimor nr. 3: Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të hollësishëm të pretendimeve ankimore dhe analizimit të fakteve dhe argumenteve, ka konstatuar se AK-ja nuk ka formuluar në mënyrë të qartë kërkesën e parashtruar në FTD për mundësitë teknike

dhe/ose profesionale. Formulimi i paqartë i kësaj kërkesë krijon hapësirë për interpretime të ndryshme, gjë që mund të shkaktojë huti te operatorët ekonomikë gjatë përgatitjes së ofertave dhe te komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të dokumenteve. Si rrjedhojë, ky pretendim ankimor është vlerësuar si i bazuar dhe kërkohet rishikimi i përmbajtjes për të siguruar një qartësi të plotë dhe konkurrencë të barabartë.

Sa i përket pretendimit se kërkesat për stafin profesional janë favorizuese dhe diskriminuese, eksperti shqyrtues ka vlerësuar se AK-ja, gjatë vendosjes së kriterëve për stafin, duhet të sigurojë që ato të jenë në përputhje të plotë me objektin e kontratës. Kërkesat për kualifikimin dhe përvojën e stafit duhet të lidhen ngushtë me natyrën e shërbimeve që kërkohen, në mënyrë që të mos krijohen pengesa të panevojshme apo diskriminim ndaj operatorëve ekonomikë.

Pretendimet ankimore janë vlerësuar të bazuara, me nevojën për qartësimin dhe përmirësimin e kriterëve në dokumentet e tenderit.

Konstatimi i ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimi ankimor nr.4 të paraqitur nga OE ankues i cili është nderlidhur me specifikat teknike dhe kërkesat kualifikuese pretendime ankimore këto të shqyruara më lart pa nevojë që të shqyrtohet edhe një herë pasi që mendimi i ekspertit është dhënë si më lart .

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Pro Acc Group SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rivlerësimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH “Ibër Lepenc” Sh.a.” me numër të prokurimit: “IL-24-8711-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Pro Acc Group SH.P.K.**

